

VENDIM
Nr. 442, datë 22.5.2013

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SHITESË PËR DISA NDRYSHIME NË KONTRATËN E
KONCESIONIT, TË FORMËS “BOT”, TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË
EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS, SI AUTORITET KONTRAKTUES, DHE
BASHKIMIT TË PËRKOHSHËM TË SHOQËRIVE “AYEN ENERJI ANONIM SIRKETI” DHE
“AS ENERGY” SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE GOJAN, GJEGJAN,
PESHQESH, URA E FANIT DHE FANGU**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 4 e 27 të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës shtesë për disa ndryshime në kontratën e koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoritet kontraktues dhe bashkimit të shoqërive “AYEN Enerji Anonim Sirketi”, dhe “AS Energy” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentraleve të Gojanit, Gjegjanit, Peshqeshit, Ura e Fanit dhe Fangut, sipas tekstit dhe anekseve që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha